

REPUBLIKA POPULLORE Ë SHQIPERISE
PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR

DEKRET

Për aprovimin e Statutit të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë,
Në mbështetje të nenit 7 të Dekret-ligjës Nr.743 d. 26.11. 1949 mbi Komunitetet fetare;
Mbi propozimin e Qeverisë

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR
DEKRETON:

1. Aprovohet Statuti i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij Dekreti.
2. Ky Dekret hyn në fuqi menjëherë.
Tiranë, më 4 Maj 1950
Nr. i Dekretit; 1065

*Për Presidiumin e Kuvendit Popullor
Të Republikës Popullore të Shqipërisë*

SEKRETARI:

(Sami Baholli) d.v.
KRYETARI
(Dr. OMER NISHANI) d. v.

STATUTI I KISHIES ORTHODHOKSE AUTOQEFALE TE SHQIPERISE

I gjithë kleri dhe populli Orthodhoks i Republikës popullore të Shqipërisë, pjesë e pandarë e Kishës së Shenjtë, të Përgjithshme dhe Apostolike, është person juridik dhe përbëhet prej të gjithë Orthodhoksëve që banojnë brënda territorit të Republikës Popullore të Shqipërisë si edhe prej atyre Shqiptarëve Orthodhoksë që banojnë jashtë Atdheut dhe ruan të pa prekëshme, si të gjitha Kishat e tjera Orthodhokse, parimet dogmatike, kanonet e hirëshme apostolike e sinodhikë, si edhe traditën e shenjtë.

NENI 2

Marrëdhëni e Kishës me Shtetin, të përcaktuara në artikullin 16 të Statutit Themeltar të Republikës Popullore të Shqipërisë, kryhen në konformitet me dispozitat përkatëse të Ligjit në fuqi mbi Komunitetet fetare.

NENI 3

Gjuha zyrtare e Kishës është Shqipja, por në shërbimet fetare mund të përdoren dhe gjuhë të tjera.

NENI 4

Krahas me zhvillimin e ndjenjave fetare Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë do të zhvillojë në besimtarët dhe ndjenjat e besnikërisë ndaj Pushtctit të popullit dhe të Republikës Popullore të Shqipërisë, si edhe ndjenjën e Atdhe-dashurisë dhe të përforcimit të Bashkimit Kombëtar. Prandaj gjithë funksionarët dhe personeli i saj, duhet të jenë shtetas shqiptarë, të ndershëm, besnikë të popullit dhe të Atdheut dhe të gëzojnë të gjithë të drejtat civile.

NENI 5

Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë do të mbajë lidhje bashkëpunimi dhe do ti shfojë e përforcojë këto lidhje me ato Kisha Ortodokse motra, të cilat interpretojnë dhe praktikojnë drejt parimet e larta ungjillore mbi paqën dhe vëllazërimin e vërtet ndërmjet popujve dhe të cilat denoncojnë çdo veprimitari dhe tentativë nxiteje për prishjen e paqës, dashurisë dhe vëllazërinët ndërmjet popujve të mbarë botës.

NENI 6

Lutjet që bëhen në Kishë gjatë meshtimeve dhe ceremonive të tjera fetare për Autoritetet Shtetnore, formulohen prej Kryesisë së Kishës dhe vihen në përdorim, mbasi më parë të merret pëlqimi i Autoriteteve kompetente të Shtetit.

NENI 7

Asnjë klerik nuk mund të ushtrojë funksionet e fesë Orthodhokse në Shqipëri, pa qënë i emëruar dhe i lidhur me Kishën Ortodhokse Autoqefale të Shqipërisë.

ORGANIZIMI

NENI 8

Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë e organizuar si Kryepiskopatë me titull: "Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë", si mbas rregullave kanonike dhe administrative përfshin:

1) Mitropolinë e Tiranës-Durrësit me këto zëvëndësi mitropolitane lokale:

a) Të Tiranës; b) Të Durrësit; c) Të Shkodrës; ç) Të Kavajës; d) Të Elbasanit

2) Episkopatën e Beratit me këto zëvëndësi episkopale lokale:

a) Të Beratit; b) Të Vlorës; - c) Të Fierit; ç) Të Lushnjës.

3) Episkopatën e Gjirokastërës me këto zëvëndësi Episkopale Lokale:

a) Të Gjirokastërës; b) Të Pogonit; c) Të Delvinës; ç) Të Sarandës; d) Të Himarës; dh) Të Përmetit.

4) Episkopatën e Korçës me këto zëvëndësi episkopale Lokale:

a) Të Korçës; b) Të Kolonjës; c) Të Leskovikut; ç) Të Pogradecit

NENI 9

Me vendim të Këshillit Mikst, mund të krijohen episkopata për Shqiptarët Orthodhoksë jashtë shtetit, të varura nga Kisha Shqiptare mëmë.

Sinodhi i Shenjtë

NENI 10

Sinodhi i Shenjtë i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, i përbërë prej episkopëve efektivë, nënë Kryesinë e Mitropolitit të Qëndrës, Kryepiskopit të gjithë Shqipërisë, është autoriteti më i lartë për të gjitha çështjet dogmatike, kanonike dhe spirituale, si dhe për ato çështje kishtare që hyjnë në sferën e kompetencës së tij.

NENI 11

Kompetencat e Sinodhit të Shenjtë janë:

- a) Të kryejë imisionin e shenjtë dhe të ruajë unitetin dogmatik, kanonik, të traditës së shenjtë dhe të kultit me të gjitha patriarchitë e shenjtë dhe me Kishat Orthodhokse Autoqefale.
- b) Të ruajë unitetin dogmatik, kanonik, të traditës së shenjtë dhe të kultit në Kishën Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë.
- c) Të shqyrtojë çdo çështje dogmatike, kanonike të traditës kishtare dhe të kultit dhe ta zgjidhi këtë në konformitet me doktrinën e Kishës Orthodhokse Lindore.
- ç) Të zgjedhi Kryepiskopin dhe Episkopët në konformitet me kanonet e shenjtë dhe traditën kishtare, si dhe në konformitet me dispozitat ligjore në fuqi, dhe të lëshojë qërkoret përkatëse për fronëzimin e Kryepiskopit.
- d) Të vendosi mbi lutjet për dorëheqjen e anëtarëve të tij.
- dh) Të gjykojë me kompetencë ekskluzive dhe në konformitet me dispozitat e kanoneve të shenjtë dhe të ligjeve përkatëse në fuqi anëtarët e tij për shkelje dogmatike dhe kanonike.
- e) Të gjykojë çështjet që kanë të bëjnë me katherizim (çveshje) të ndonjë kleriku.
- ë) Të udhëzojë e të mbikqyri që aktiviteti i organeve ekzekutive në dioqeza të kryhet konform rregullave ligjore.
- f) Të vendosi mbi çështjet e çdo natyre që hyjnë në kompetencën e tij, si edhe mbi ato që s'janë caktuar me anë ligjesh, Statuti ose Rregulloresh si kompetencë e ndonjë organi tjetër kishtar.
- g) Të interpretojë për të gjitha organet kishtare dispozitat e Statutit dhe Rregullores së Përgjithëshme të administrimit.
- gj) Të thërasë Kongrese Kishtare, kur e lypin nevojat e larta të Kishës.

NENI 12

Në mungesë të Kryetarit, për çfarëdo arsyen të justifikuar, Sinodhi i Shenjtë kryesohej prej episkopit titullar më të vjetër në hirotoni.

NENI 13

Sinodhi i Shenjtë mblidhet detyrimisht një herë në vit dhe jashtëzakonisht sa herë e lyp nevoja.

NENI 14

Thirrja dhe caktimi i rendit të ditës, bëhet prej Kryetarit të Sinodhit një muaj më përpara. Për mbledhje të jashtëzakonshme, afati mund të jetë më i shkurtër.

Në qoftë se Kryetari refuzon, për cilëndo arsyen, të thërrasi mbledhjen e detyrueshme të Sinodhit, ai mblidhet detyrimisht brenda 15 ditëve nga data e kërkesës, kur një gjë e tillë kërkohet, të paktën prej dy anëtarëve të tij me shkresë dhe pasi të ketë kaluar afati vjetor i mbledhjes së detyrueshme të Sinodhit. Në qoftë se kryetari refuzon, për cilëndo arsyen, të thërrasi Sinodhin në mbledhje të jashtëzakonshme, ai mblidhet detyrimisht kur një gjë e tillë kërkohet me shkresë, të paktën prej dy anëtarëve të tij, brënda një muaji nga data e shkresës.

NENI 15

Sinodhi i Shenjtë konsiderohet i mbledhur rregullisht kur ndodhet prezent gjysma plus një e numrit të të gjithë anëtarëve. Ai merr vendime të vlefshme me votën e shumicës së thjeshtë të anëtarëve prezent dhe në rast barazije votash, paravlen ana e Kryetarit.

NENI 16

Kandidatët për Episkopë, përvèç cilësive që kërkojnë kanonet e Kishës, duhet të janë të diplomuar prej një Fakulteti teologjik orthodhoks. Por, në mungesë Kandidatësh episkopë të diplomuar prej një fakulteti teologjik, mund të dorëzohen episkopë dhe kandidatë, të cilët nuk kanë një kulturë të tillë, por që janë të dalluar në veprimitari kishtarc dhe patriotike dhe që janë të astë si autodidaktë.

NENI 17

Kryepiskopi dhe episkopët, kur bëhen anëtarë efektivë të Sinodhit të Shenjtë betohen përpara tij me këtë formulë betimi:

“Betohem mbi ndërgjegjjen time përpëra Perëndisë se do të ruaj besnikërinë, ndaj dogmave, kanoneve dhe traditave kishtare orthodhokse, ndaj popullit dhe Republikës Popullore të Shqipërisë, dhe ndaj parimeve demokratike të konsakruara me anë të Statutit të saj themeltar.

NENI 18

Episkopë titullarë efektivë pa dioqezë ekzistuese, nuk mund të janë më tepër se një.

NENI 19

Sinodhi ka një sekretar të përgjithshëm të zgjedhur prej tij me propozim të kryetarit, nga i cili dhe dekretohet.

NENI 20

Cdo botim me përbajtje fetare kishtare, nuk mund të vihet në përdorim në Kishën Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, pa pëlqimin dhe aprovimin e Sinodhit të Shenjtë.

NENI 21

Sinodhi i shenjtë do të punojë për edukiunin e klerit dhe të besimtarëve, në mënyrë që të luftohen dhe të zhduken supersticionet.

NENI 22

Agnë laik ose murg nuk mund të dorëzohet prift ose dhjak pa patur pëlqimin e Sinodhit të Shenjtë.

NENI 23

Në gradë nderi (ofiq kishtar) nuk mund i i jepet priftërinjve, cilido qoftë aktiviteti i tyre, pa propozim të titullarit respektiv dhe aprovim përkatës, të Sinodhit të Shenjtë dhe në konformitet me dispozitat përkatëse të Rregullores së Përgjithëshme të administrimit.

KRYEPISKOPI

NENI 24

Kryepiskopi i gjithë Shqipërisë është Kryetar i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë.

NENI 25

Kryepiskopi është i pari në Jerarhët e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë dhe Mitropolit i Dioqezës së Tiranës-Durrësit.

NENI 26

Kryepiskopi gjëzon të gjitha të drejtat e parapara në kanonet e shënja, në këtë Statut dhe në Rregulloren e Përgjithëshme të administrimit, si edhe në Ligjën mbi Komunitetet fetare.

Titulli i tij është: Kryehirësia e Tij, Kryetari i Kishës Orthodhokse Autoqefale, Mitropolit i Tiranës - Durrësit dhe Kryepiskop i gjithë Shqipërisë.

Kujtimi i tij (fimi) në shërbesat kishtare bëhen konform kanoneve të shenja dhe zakonit të Kishës sonë.

NENI 27

Kryepiskopi ka këto detyra:

- Thërrët dhe kryeson organet Qendrore të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë.
- Vë në zbatim vendimet e organeve Qendrore të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë.
- Përfaqëson Kishën Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë para Autoriteteve dhe kudo që e lyp nevoja, personalisht ose me anë të deleguarish.

ç) Mban lidhje me Kishat e tjera Orthodhokse për çështjen kishtare nëpërmjet kanalit të paraparë nga ligja mbi Komunitetet fetare.

d) Lëshon letra pastorale për gjithë kishat Orthodhokse Autoqesale Të Shqipërisë, duke iu përbajtur dispozitive përkate të Ligjës mbi Komunitetet fetare.

dh) Dërgon këshilla vëllazërore jerarhëve të kishës dhe pajton mosmarrveshjet eventuale ndërmjet tyre.

e) Kujdesohet për kryerjen sa më parë të formalitetëve të nevojshme për plotësimin e dioqezave vakante, brënda 40 ditëve.

f) Viziton në mënyrë kolegiale, kur e shikon të udhës, jerarhët e kishës dhe detyrimi qëndrat e iuridikcionit të dioqezës së tij, të paktë një herë në vit.

g) Lëshon qarkoret e emërimit përfronëzimin e episkopëve.

h) Emëron zëvëndës episkopalë të përgjithshëm provizorë, kur fronet episkopale mbeten vakante duke iu përbajtur dispozitive përkate të Ligjës mbi Komunitetet fetare.

i) Afati qëndrimi të një dioqze vakante me një zëvëndës episkopal të përgjithshëm provizor, caktohet në Rregulloren e Përgjithëshme të Administrimit

j) Pranon ankesat e paraqitura eventualisht kundër titullarëve të dioqezave dhe disponon për hetime, me anën e një kleriku anëtar të Sinodhit, rezultatin e të cilave ia parashtron Sinodhit të Shenjtë.

j) Ushtron dhe çdo të drejtë tjetër që i është akorduar me anë kanonesh, ligjesh dhe rregulloresh.

NENI 28

Përveç sekretarit të përgjithshëm dhe personelit tjetër, i cili parashikohet në Rregulloren e Përgjithëshme të administrimit me dispozita të posaçme, Kryepiskopi ka edhe një episkop ndihmës, i cili është anëtar i Sinodhit pa mbajtur përgjegjësinë e administrimit të ndonjë dioqze ekzistuese dhe kryen çdo detyrë që i ngarkohet nga Kryepiskopi, duke u titulluar në hymnin e tij si Episkopi i Apollonisë.

EPISKOPI

NENI 29

Episkopi titullar është organi drejtues i një dioqze dhe gjëzon të gjitha të drejtat e parashikuara nga kanonet e shënja, nga ky Statut dhe nga Rregullorja e Përgjithëshme e administrimit, si dhe nga ligjet përkate të fuqi.

NENI 30

Të drejtat dhe detyrat e episkopit janë:

a) Të drejtojë dioqzen brenda kufijve të caktuar nga kanonet dhe rregullat në fuqi.

b) Të përfaqsojë dioqzen para Autoritetetëve Shtetore lokale dhe kudo që e lyp nevoja, personalisht ose me anë të deleguarish prej tij.

c) Të dorëzojë (hirotonisi) priftërinjtë dhe të japi ofiqe klerikale me propozim të tij dhe pëlqim përkatës të Sinodhit.

ç) Të heqi vërejtjen dhe të qortojë klerikë të dioqezës së tij përfajë të vogla dhe të pezullojë këta nga funksionet e tyre përfajet që përbëjnë skandal, deri sa kjo çështje të gjyket nga gjykata spirituale.

d) Të vizitojë, të paktën, një herë në vit dioqzen e tij, përf të kontrolluar ecjen e punëve kishtare dhe përf të dhënë udhëzime përkatëse, duke i bërë një raport Sinodhit të Shenjtë mbi konstatimet e kryera.

NENI 31

Episkopi gjëzon dhe çdo të drejtë tjetër që i është ngarkuar me anë kanonesh, ligjesh dhe rregulloresh, si edhe ato që do të caktohen më hollësishët në Rregulloren e Përgjithëshme të Administrimit.

NENI 32

Episkopi është i detyruar të qëndrojë vazhdimesh në dioqzë, me përjashtim kur merr pjesë në mbledhjen e Sinodhit të Shenjtë ose në mbledhje të tjera zyrtare, si edhe kur ndodhet me leje.

ZEVENDESIA MITROPOLITANE DHE EPISKOPALE LOKALE

NENI 33

Zëvëndësija mitropolitane ose episkopale Lokale është një rrëthi administrativ kishtar që përfshinë një numur famullish të një dioqze.



NENI 34

Kryepiskopi, nën cilësinë e mitropolitit të qëndrës dhe të titullarit të dioqezës Tiranës-Durrësit, emëron në qëndrën e çdo zëvëndësije mitropolitane lokale të juridiksonit të dioqezës së tij një zëvëndës mitropolitan lokal klerik, i cili administron zëvëndësinë mitropolitane lokale në emër të mitropolitit, nën udhëzimet e tij direkte dhe në konformitet me dispozitat e këtij Statuti, të Rregullores së Përgjithëshme të Administrimit dhe të ligjeve përkatës.

Në të njëjtën mënyrë veprojnë dhe titullarët e dioqezave të tjera, duke emëruar secili në qëndrën e çdo zëvëndësije episkopale lokale të juridiksonit të dioqezës së nji zëvëndës episkopal klerik, i cili administron zëvëndësinë episkopale lokale në emër të titullarit të dioqezës, nënë udhëzimet e tij direkte dhe në konformitet me dispozitat e këtij Statuti, të Rregullores së Përgjithëshme të administrimit dhe të ligjeve përkatëse.

NENI 35

Zëvëndësi mitropolitan ose episkopal lokal kryeson mbledhjet e Këshillit kishtar (Dhimogjerondisë) të qytetit të qëndrës së zëvëndësisë mitropolitane ose episkopale lokale dhe kujdeset që urdhrat, vendimet dhe dispozitat e autoriteteve kishtare më të larta, si edhe dispozitat ligjore përkatëse, të viihen në zbatim në të gjitha kishat e juridiksonit të tij.

NENI 36

Zëvëndësi mitropolitan ose episkopal lokal ushtron dhe çdo të drejtë tjetër që parashikohet në dispozita të veçanta të Rregullores së Përgjithëshme të administrimit.

FAMULLITE DHE FAMULLITARET

NENI 37

Famullija është bashkimi kishtar i besnikëve klerikë dhe laikë, të fesë së krishterë orthodhokse, që banojnë në nji territor të caktuar (katund apo qytet).

NENI 38


Cdo famulli, ka të drejtë të ketë nji ose më shumë famulltarë, simbas numurit të besnikëve dhe të kishave të famullisë dhe simbas gjëndjes së saj ekonomike.

NENI 39

Famulltarët zgjidhen nga këshillat kishtare të dala nga gjiri i popullit të çdo famullije dhe aprovohen prej titullarit përkatës. Por, në katunde ku gruimbullimi i besnikëve bëhet më kollaj mund të zgjidhen direkt nga populli.

NENI 40

Në katunde famulltarë është kryetari i këshillit kishtar (kujdestarisë kishtare)



NENI 41

Famulltari në katunde është përgjegjës për të vënë në zbatim dispozitat e këtij Statuti, të Rregullores së Përgjithëshme të Administrimit dhe të Ligjës mbi Komunitetet fetare.

NENI 42

Kur në një famulli shërbejnë më tepër se një famulltar, numuri i familjeve që shërbehen prej tyre, ndahet në proporcione të barabartë.

NENI 43

Përsa i përket plotësimit të nevojavë fetare të kishës, famulltarët janë gjithmonë në dispozicion të titullarëve të dioqezave, por për transferimin e tyre është i nevojshëm aprovimi dhe vendimi i këshillave kishtare (Dhimogjerondive).

NENI 44

Dispozita më të hollësisht mbi famullitë dhe famullitarët, caktohen në Rregulloren e Përgjithëshme të administrimit.

KESHILLAT KISHTARE

Këshilli Mikst. Këshilli ekonomik. Këshillat kishtare të qyteteve dhe të katundeve. Këshillat Manastirjale.

NENI 45

Organë më i lartë i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë për të gjitha çështjet administrative-ekonomike, si edhe për çdo çështje tjetër që nuk hyn në sférën e kompetencës e Sinodhit të Shenjtë, është Këshilli Mikst, i përbërë prej titullarëve të dioqezave ekzistuese, të cilët janë vetvitet anëtarë të tij, dhe për katër anëtarësh llaik, një për çdo dioqezë, nën kryesinë e Kryepiskopit, për një periudhë prej katër vjetësh. Episkopi ndihmës merr pjesë në Këshillin Mikst me votë konsultative.

NENI 46

Mënyra e zgjedhjes së katër anëtarëve laikë të Këshillit Mikst si edhe kompetencat dhe të drejtat e tyre, caktohen hollësisht në Rregulloren e Përgjithëshme të administrimit të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë.

Për këtë herë, katër anëtarët laikë të Këshillit Mikst, zgjidhen prej Kongresit.

NENI 47

Këshilli Mikst harton Rregulloren e Përgjithëshme të administrimit të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë si dhe Rregulloren mbi sigurimin e klerit, në konformitet me dispozitat e këtij Statuti dhe me dispozitat e këtij Statuti dhe me dispozitat ligjore në fuqi, duke ia parashtruar Këshillit Ministerial për aprovim.

NENI 48

Këshilli Mikst shqyton buxhetin konsumativ të vitit të kaluar dhe harton buxhetin prementiv për vitin e ardhshëm.

Kishën Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë para gjykatave e përfaqason një anëtar laik i Këshillit Mikst i deleguar ad hoc prej tij. Ky, përveç të drejtave të tjera, ka edhe të drejtën të bëjë pajtime, të deferojë, pranojë ose referojë benë deçizore si edhe të emërojë përfaqques ligjore para gjykatava, me po ato të drejta, ose me të drejta më të pakta.

NENI 49

Këshilli Mikst i thirrur prej Kryetarit, mblidhet zakonisht një herë në vit dhe jashtëzakonisht sa herë që e lyp nevoja.

Ai merr vendime me shumicë të thjeshtë votash dhe konsiderohet i mbledhur rregullisht kur ndodhen prezant, përveç kryetarit dhe katër anëtarë, në proporcione dy klerikë dhe dy laikë. Në rast barazie votash, paravlen ana e Kryetarit.

NENI 50



Këshilli Mikst mund të modifikojë nene të këtij Statuti që nuk u referohen dogmave, kanoneve dhe traditës së shenjtë; gjithashtu mund të bëjë dhe shtesa nenesh. Por, për të qënë këto modifikime dhe shtesa të vlefshme, duhet një kuorum të paktën prej 7 anëtarësh dhe një vendim i marrur, të paktën, prej 6 (gjashtë) anëtarësh.

NENI 51
Pranë Kryesisë së Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë funksionon një Këshill Ekonomik i Përherëshëm, i përbërë prej Kryepiskopit dhe prej katër anëtarësh, në proporcione një klerik dhe tre laikë, nga një për çdo dioqzë, nën Kryesi të Kryepiskopit.

NENI 52
Këshilli Ekonomik është organ i Këshillit Mikst për administrimin ekonomik të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë gjatë vitit financiar dhe përgjegjës para tij. Anëtarët e Këshillit ekonomik zgjidhen prej Këshillit Mikst për një periudhë prej katër vjetësh. Këshilli Ekonomik konsiderohet i mbledhur rregullisht kur, përvèç kryetarit ndodhen prezant dhe tre anëtarë. Ai merr vendime të vlefshme me shumicën e tre anëtarëve prezant.

NENI 53
Kompetencat dhe detyrat e Këshillit Ekonomik, caktohen shprehimisht në Rregulloren e Përgjithëshme të administrimit.

NENI 54
Funksionet e Sekretarit të Këshillave Mikst dhe Ekonomik, i kryen sekretari i përgjithshëm i Sinodhit.

NENI 55
Komuniteti Orthodoks i çdo qyteti zgjedh një këshillë kishtare lokale (Dhimogjerondi), e cila kryesohet prej zëvëndësmit mitropolitan ose episkopal lokal dhe administron famullitë e qytetit dhe pasuritë e tyre të lujtshme dhe të palujtshme. Në këtë këshillë merr pjesë dhe një famulltar me të drejtë vote, i deleguar prej klerit të atij qyteti. Këshilli kishtar i qytetit mund të zgjedhi nga ose jashtë gjirit të tij dy deri tre kujdestarë për çdo kishë të qytetit, të cilët janë përgjegjës para tij dhe administrojnë kishën në emër të tij.

NENI 56
Në çdo katund zgjidhet një këshillë kishtare (kujdestari), e përbërë prej dy deri katër anëtarësh laikë, nën kryesinë e famullitatit, e cila administron kishën osc kishat e katundit dhe pasuritë e tyre të lujtshme dhe të palujtshme.

NENI 57
Cdo manastir drejtohet dhe administrohet nga një këshillë manastiriale (igumeniale) nën kryesinë e një igumeni ose administratori klerik, të emëruar nga titullari i dioqzës, e cila këshillë është përgjegjës përpara organeve ekonomike të qëndrës dhe titullarit të dioqzës respektive, për administrimin e pasurisë së luajtshme dhe të palujtshme të manastirit, si edhe për mirëmbajtjen e tij.

NENI 58
Në këshillat kishtare kanë të drejtë të zgjedhin dhe të zgjidhen gjithë banorët orthodhoksë të Republikës Popullore të Shqipërisë, që kanë mbushur moshën ligjore.

NENI 59
Mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të këshillave kishtare të qyteteve (Dhimogjerondive), të anëtarëve të këshillave kishtare të katundeve (kujdestarive) dhe të anëtarëve të këshillave manastiriale (igumenjale), si edhe kompetencat dhe detyrat e tyre, caktohen në dispozita të posaçme të Rregullores së Përgjithëshme të administrimit, në konformitet me fryshtën e këtij Statuti dhe dispozitat ligjore në fuqi.

PASURITE KISHTARE

NENI 60

Të gjitha pasuritë që u përkasin: Kryepiskopatës, episkopatave, zëvëndësive mitropolitane ose episkopale lokale, famullive dhe manastireve, përbëjnë pasuritë kishtare.

NENI 61

Pasuritë që disponojnë kishat e komuniteteve orthodhoksë të qyteteve dhe të katundeve, janë pasutitë e tyre dhe administrohen në konformitet me dispozitat e Rregullores në fuqi. Kjo vlen edhe përsa u përket pasurive që disponojnë manastiret.

NENI 62

Nga pikpanja e destinimit të sajë, pasurija kishtare dallohet: në pasuri gjérash të shenja dhe në pasuri të zakonshme.

Pasuri gjérash të shenja është ajo që përbëhet prej gjérash dhë objektesh të destinuara për kultin hyjnor. Këto s'mund të shiten, por mund të dhurohen me vendim të këshillave kishtare.

Pasuri e zakonshme është ajo që përbëhet prej mijetesh, me anën e të cilave mbahet kisha dhe personeli shërbyes.

NENI 63

Shtimi, shitja dhe administrimi i pasurisë kishtare, kontrolli dhe verifikimi i saj bëhet në konformitet me dispozitat ligjore përkatëse dhe dispozitat e posaçme të Rregullores së Përgjithëshme të Administrimit të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë.

MBI TE ARDHURAT DHE SHPENZIMET

NENI 64

Shpenzimet përmblajten e kultit, përballohet nga kontributet vetëdashëse të besnikëve dhe nga të ardhurat e vetë kishës ose manastirit, ndërsa rrogat e meshtarëve dhe të nënpunësave si edhe shpenzimet e ndryshme në qëndrat e dioqezave dhe zëvëndësit e tyre mwartëse, përballohen nga të ardhurat kishtare dhe nga subvensioni eventual i Shtetit.

SIGURIMI I KLERIT

NENI 65

Pranë Kryesisë së Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë krijuhet "Fondi i sigurimit të Klerit" i cili ka përqelli qëllim të sigurojë të gjithë klerikët e Shqipërisë në raste pa aftësije përmes kryer misionin e shenjtë dhe dalje në pension, si edhe familjet e tyre në raste vdekjeje.

NENI 66

Fondi i sigurimit të klerit drejtohet dhe administrohet nga Këshilli Mikst në bazë të dispozitave të një rregulloreje të posaçme të hartuar nga Këshilli Mikst, konform dispozitave ligjore përkatëse.

PREGATITJA E KLERIT. KONFERENCAT DHE BOTIMET

NENI 67

Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë, duhet të mbajë shkolla fetare përgatitjen e funksionarëve të saj fetarë.

NENI 68

Dispozitat mbi organizimin e një shkolle të mesme fetare dhe mbi programët e funksionimit të saj, caktohen në një rregullore të veçantë të hartuar nga Sinodhi i Shenjtë dhe të aprovuar nga Këshilli Ministerjal.

NENI 69

Për perfektionimin e priftërinjve në kryerjen e misionit kishtar dhe përmes t'u dhënë këtyre sqarimeve rreth problemeve aktuale që i referohen aktivitetit dhe rolit të Kishës përmirë e shoqërisë dhe të popullit, zhvillohen herë pas here konferanca, të cilat kryesohen nga vërtetë titullari ose nga një i deleguari i tij, ose nga zëvëndësi i tij lokal i autorizuar posaçërisht, por gjithmonë nën porosinë direkte të titullarit.

NENI 70

Për zhvillimin e konferencave, duhet të kërkohet më parë leja përkatëse nga ana e Autoriteteve kompetente në konformitet me dispozitat ligjore në fuqi mbi mbledhjet publike.

NENI 71

Prenë Kryesisë së Kishës duhet të botohet një revistë fetare e përmuajshme, me përbajtje të dobishme për kishën, klerin dhe popullin. Konstitut e funksionimit dhe të organizimit të revistës fetare, caktohen hollësishët në Rregulloren e Përgjithëshme të administrimit.

NENI 72

Në botimin e revistës fetare, do të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit mbi Komunitetet fetare.

MASAT DIŞPLINORE

NENI 73

Në qëndrën e çdo dioqeze funksionon një gjykatë spirituale, e përbërë prej titularit të dioqezës si kryetar dhe dy klerikëve graduar si anëtarë, për të gjykuar në formë të prerë, brënda 30 ditëve nga data e kryerjes së fajit, të gjithë klerikët e juridiksionit të dioqezës, përfaje të lehta gjer në 15 ditë argji, me ose pa prerje rroge, dhe përfaje që përbëjnë skandal gjer në një muaj me ose pa prerje rroge. Procedura që do të ndiqet përfajmin e këtyre sajeve, caktohet në Rregulloren e Përgjithëshme.

NENI 74

Për të gjitha fajet dogmatike dhe kanonike dhe shkeljet disciplinore, që e kalojnë kompetencën e gjykimit dhe ndëshkimi nga ana e titularit, është kompetent Sinodhi i Shenjtë, i cili gjykon dhe vendos në formë të prerë mbi fajet e përmëndura si për anëtarët e tij ashtu edhe për çdo klerik ose murg.

NENI 75

Kur një anëtar i Sinodhit gjykohet përfajtës i tillë, ai vetë nuk merr pjesë si anëtar i Sinodhit. Mbi këtë flitet më hollësishët në rregullore.

NENI 76

Për çdo lloj ndëshkimi, vendimet e Sinodhit mirren me shumicë të thjeshtë votash.

NENI 77

Kryetari i Sinodhit, ose Sinodhi, kur kryetari është vetë i akuzuar, pezullon me një herë nga funksionet e tij çdo funksionar të Kishës, klerik dhe llaik, kur një gjë e tillë kërkohet nga autoritetet kompetentë të Shtetit përfshikelje të dispozitave të nenit 15 të ligjës mbi Komunitetet fetare.

NENI 78

Vendimet e Sinodhit përmes masa disciplinore, do t'i konfirmohen dispozitave përkatëse të nenit 14 të Ligjës mbi Komunitetet fetare.

NENI 79

Cdo klerik i katherizuar (çpriftëruar) me vendim të Sinodhit detyrohet të heqi uniformën fetare dhe ndalohet të kryejë shërbime fetare.

NENI 80

Mënyra e procedurës së gjykimit të çështjeve disciplinore, që i referohen kompetencës së Sinodhit, si edhe dispozita të tjera përkatëse, caktohen hollësishët në Rregulloren e Përgjithëshme të Administrimit.

MBISHKRIMET. SHENJAT SIMBOLIKE DHE VULAT NE PERDORIM

NENI 81

Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë ka këto mbishkrime:

- Për Kryesinë: "Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë; Kryesija e Sinodhit të Shenjtë"
- Për Dioqezat: "Kisha Orthodhokse Autopqefale e Shqipërisë; Episkopata e"
- Për zëvëndësitet mitropolitane ose episkopale lokale "Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë; Mitropolija ose episkopata e; zëvëndësja mitropolitane ose episkopale lokale e"

NENI 82

Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë si shenjë simbolike ka "Mitrën episkopale me kryq".

NENI 83

Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë ka në përdorim këto vula:

- a) Për Kryesinë e Kishës: Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë; Kryepiskopata".
- b) Për episkopatat: Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë, episkopata e
- c) Për zëvëndësitë mitropolitane lokale mvartëse të Kryepiskopatës: Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë; zëvëndësia mitropolitane lokale e
- ç) Për zëvëndësitë Episkopale, lokale mvartëse të episkopatave: "Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë; zëvëndësia episkopale e
- d) Për të gjitha famullitë: " Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë famullija e....."
- dh) Për të gjithë manastiret: "Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë; manastiri i

NENI 84

Vulat e përmëndura në gërmat a,b,c,ç,d,dh, të nenit 83, kanë në mes një kryq.

DISPOZITA TE PERGJITHSHME DHE TRANZITORE

NENI 85

Në mungesë episkopësh titullarë, në krye të një dioqze mund të zgjidhet në të njëjtën mënyrë një klerik i dalluar me titull:

"Zëvëndës Episkopal i Përgjithshëm", i cili përsa kohë që administron dioqezën vakante, ka po ato të drejta që ka edhe një episkop titullar, si edhe të njëjtën të drejtë anëtarësije në Sinodh, me përjashtim të atyre kompetencave që i përkasin eksluzivisht gradës episkopale. Edhe ky jep të njëtin betim përpara Sinodhit të Shënjtë.

NENI 86

Me plotësimin e një dioqze vakante me anën e një episkopi titullar, zëvëndësi episkopal i përgjithshëm i saj, e humbet të drejtën e administrit të dioqzës së plotësuar, por mbetet anëtar i rregullt i Sinodhit dhe në dispozicion të tij, me votë konsultative.

NENI 87

Anëtarët e Sinodhit, për çdo rast largimi nga funksionet e tyre, gëzojnë të drejtën e pensionit, me përjashtim të rastit kur këta pushohen përfajë dhe veprimitari anti-kishtare dhe anti-patriotike.

NENI 88

Gjatë vitit, për çdo çështje që nuk lypin mbledhje të jashtëzakonëshme të Sinodhit dhe të Këshillit Mikst, Kryepiskopi mund të kërkojë mendimin dhe pëlqimin e anëtarëve të tyre me korrespondencë. Personeli i Kryepiskopatës dhe i episkopatave, si edhe detyrat e tija, caktohen me dispozita të veçanta të Rregullores së Përgjithshme të administrit.

NENI 89

Për caktimin e rrogave të funksionarve dhe të nënëpunsave të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, ndiqet kriteri që ndiqet edhe përfunksionarët dhe nënëpunësit e Shtetit, në konformitet me dispozitat ligjore përkatëse.

NENI 90

Në rast mbledhjeje, anëtarëve të këshillave ju paguhen djeta në konformitet me dispozitat ligjore përkatëse. Për anëtarët e këshillave që mund të mos kenë ndonjë nënëpunësi, dietat caktohen nga Kryesija e Kishës, nëse nuk ekziston ndonjë dispozitë ligjore përfariat e kësaj kategorije.

NENI 91

Për sigurimin e jetesës së jerarhëve që nuk gëzojnë të drejtë pensioni, kisha nuk merr ndonjë angazhim, në qoftë se këta nuk shkojnë në një nga manastiret që u cakton Sinodhi i Shenjtë.

NENI 92

Ky Statut i përpiluar në bazë të parimeve dhe të dispozitave të përgjithëshme që përbahen në kanonet e Kishës, dhe në konformitet me dispozitat përkatëse të Statutit Themeltar të Republikës Popullore të Shqipërisë dhe të Ligjës mbi Komunitetet fetare, për të përcaktuar mënyrën simbas së cilës Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë nregullon, drejton dhe administron çështjet e saja fetare, është dlie mbetet i detyrueshëm për krejt Kishën Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, pasi më parë të aprovohet nga Presidiumi i Kuvendit Popullor.

Delegatët e Tiranës

Kryepiskop Paisi Vodica d. v.
Ikonom At Marko Papajani d. v.

Dhimitër Beduli d. v.

Jorgji Pano d. v.

Delegatët e Durrësit

Stavrofor At Erazmi Jorgo d. v.
Thoma Papakostandini d. v.
Kozma Teneqexhiu d. v.

Delegatët e Elbasanit

Aleksandër Xhuvani d. v.
Ilia Trandafili d. v.

Delegati Kavajës

Jorgji Surra d. v.

Delegati Shkodrës

Stav. At Llazar Popoviq d. v.

Delegati Pogradecit

At. Risto Bitro d. v.

Delegatët e Beratit

At Kostandin Arbëri d. v.

Siku Gjoka d. v.

Caci Dollani d. v.

Delegatët e Vlorës

Thimi Opingari d. v.

Dhimitër Mërtiri d. v.

Delegatët e Fierit

Stav. Ik. At Polizoi d. v.

Marija Bakalli d. v.

Delegatët e Lushnjës

Arhimadrit Dhimitër Kokoneshi d. v.

Llazar Bozdo d. v.

Jorgji Dhamo d. v.

At Jorgji Prifti d. v.

Delegatët e Korçës

Arhimandrit Sofron Borova d. v.

Stav. At. Llazar Pashko d. v.

Av. Kristaq Pilika d. v.

Spiro Luarasi d. v.

Pandi Progri d. v.

Xhorxhi Papa d. v.

Delegatët e Kolonjës

Stav. At Naum Rehova d. v.

Vasil Tane Arëza d. v.

Delegatët e Përmetit

Lilo Proko d. v.

At Mina Dhama d. v.

Nisi Zhaka d. v.

Delegat i Leskovikut

Nikolla Kozma d. v.

Delegatët e Gjirokastrës

Ik. At. Aristotel Sirato d. v.

Zoto Beshari d. v.

Av. Njall Xhaj d. v.

Niko Zane d. v.

Koço Kostaqi d. v.

Niko Mastaka d. v.

Delegat i Pogonit

Dhimitor Beduli d. v.

Delegatët e Delvinës

Ik. At Vangjel Mastakuli d. v.

Minella Kuramana d. v.

Delegatët e Sarandës

At Kristo Plaku d. v.

Vasil Gjikopuli d. v.

Delegatët e Himarës

Ik. At Foto Duni d. v.

Kristo Dhima d. v.

Ky Statut është aprovuar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor me Dekret Nr. 1065 datë 4 Maj 1950.

SEKRETARI
(SAMI BAHOLLI) d.v.

Asht nji me origjinalin:

KRYETARI
(Dr. Omer Nishani) d. v.

2. Kuvendi Kleriko Laik (21 janar 1993)

Më 21 janar 1993, në Qytetin e Durrësit, u mbajt Kuvendi Kleriko-laik për problemet e kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë; Në të muarën pjesë 190 delegatë nga të gjitha anët e Shqipërisë, të cilët diskutuan gjëresisht për rimëkëmbjen e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë dhe për përmirësimin e Statutit të saj në përputhje me kushtet e reja të krijuara. Statuti i vitit 1950, të cilin po zbatojmë, ka zëvendësuar atë të vitit 1929. Në vitin 1967 shkatërruan institucionet fetare dhe me kushtetutën e vitit 1976 u ndalua të rëresisht besimi fetar. Me fitoren e demokracisë, në ligjin kushtetues përliturë dhe të drejtat e njeriut u sanksionua liria e besimit fetar. Me këto ndryshime të mëdha, rifilloi të funksionojë edhe Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë. Sapo të dalë Kushtetuta e re e republikës së Shqipërisë do të përgatitet edhe statuti i kësaj Kisha. Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë është tashmë e njohur si e tillë jo vetëm në Shqipëri por edhe nga organizma ndërkombëtare. Atë e njohin dhe e respektojnë gjithë institucionet shtetërore dhe shoqërore në Shqipëri dhe e vlerësojnë kontributin që jep ajo. Kuvendi i Durrësit bëri zgjedhjet përliturë e përgjithshëm të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë dhe këshillat e Kryepeshkopatës së Tiranës, dhe të Mitropolive të Korçës, Beratit dhe të Gjirokastrës.

3. Dispozita tranzitore

Në bazë të nenit 50 të vitit 1950 "Këshilli Mikst mund të ndryshojë nene të këtij Statuti që nuk kanë të bëjnë me dogmat, kanunet dhe traditën e hirshme, gjithashtu mund të shtojë nene" dhe pas vendimit të njëzëshëm të tij në mbledhjen e datës 9 maj 1996, ku morën pjesë të gjithë anëtarët e tij, shtohen nenet e mëposhtme përbëllimin e problemeve që rezultuan pas ndalimit të fesë nga viti 1967 deri në vitin 1990. Në kuvendin Kleriko-laik të 21 janarit 1993 "Këshilli Mikst" është zëvendësuar me emërimin "Këshilli i Përgjithshëm Kishtar".

Ai përbëhet nga Kryepeshkopi (Kryetar), Përfaqësuesit Arkihieratikë të Dioqezave, 2 klerikë të Kryepeshkopatës, 3 klerikë të tri Mitropolive dhe 3 anëtarë laikë, duke përfaqësuar respektivisht të katër krahinat kishtare. Të tjerat mbeten në fuqi sipas nenit 45.

Neni 93. Për shkak të shpërbërjes së Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë gjatë persekutimit shumëvjeçar dhe të pamundësisë absolute përliturë gjendur një kandidat me nënshtetësi shqiptare përliturë marë përsipër, si Kryepiskop, përgjegjësinë e rikrijimit të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë,

pezu i kërkesa e nenit 4 (për nevojshimën e nënshtetësisë shqiptare) për Primatin e Kishës Orthodhokse autoqefale të Shqipërisë.

Kryepiskop i Tiranës dhe gjithë Shqipërisë*.

Neni 94. Gjatë kësaj periudhe tranzitore (sipas frysë së nenit 85 të këtij Statuti) për secilën nga Episkopatat Korçës, Beratit dhe Gjirokastër zgjidhet një klerik i dalluar me titullin "Përfaqësues Arkihieratik i Episkopatës", i cili drejtë zëvendësinë kishtare me përashtim të kompetencave që i takojnë gradës së episkopit. TMështjet shpirtërore që janë në kompetencë të Sinodhit të Shenjtë i marrin përsipër vetëm anëtarët klerikë të Këshillit të Përgjithshëm Kishtar.

Neni 95. Në çdo zëvendësi kishtare mund të krijohen Shoqata: të Gruas Orthodhokse, të Rinise Orthodhokse dhe të Intelektualëve Orthodhoksë, për zhvillimin e punës katekitike, hierapostolike dhe shoqërore të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë. Shoqata dhe organizata të tëra që krijohen pa miratimin e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë nuk njihen prej saj dhe nuk mund të përfaqësojnë shprehjet e jetës së saj.

* është Fortlumturia e Tij, Kryepiskop i Tiranës dhe gjithë Shqipërisë, Anastasi, i propozuar nga ana e Këshillit të Përgjithshëm të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë dhe i zgjedhur nga ana e Patrikanës Ekumenike (24 qershor 1992), i fronëzuar rregullisht (2 gusht 1992) pas marrëveshjes edhe me Autoritetet shqiptare.

Nevojën e domosdoshme që të pezullohet kushti i nënshtetësisë shqiptare, e njohu edhe Presidenti i republikës së Shqipërisë (4 korrik 1992), i cili dhe e pranoi zgjedjen e Kryepiskopit Anastas. Së fundi, njëzëri dhe unanimisht, fronëzimin e tij e konfirmoi edhe Kongresi Kleriko-laik i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë mbajtur në Durrës më 21 janar 1993.